



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

Edicion I VIII-të
BULETINI INFORMATIV

Janar 2022

**AUTORITETI I KONKURENCËS
GJATË VITIT 2021**



Funded by
the European Union



ARRITJE TË RËNDËSISHME NË ZHVILLIMIN LEGJISLATIV DHE TË AVOKIMIT PËR KONKURENCËN

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm:

Ky është viti i dytë në të cilin thuajse çdo fjalim apo adresim i fundvitit pashmangshëm fillon me rikujtimin e vështirësive në punët e çdo institucioni për shkak të pandemisë COVID-19. Natyrisht, në këtë rast nuk bënë përjashtim as Autoriteti Kosovar i Konkurrencës. Megjithatë, unë besoj që Autoriteti ka mjaftueshëm arsye të jetë i kënaqur me arritjet e shënuara gjatë vitit që po e lëmë pas, disa prej të cilave do të paraqiten shkurtimisht në këtë edicion të radhës të buletinit informativ.



Disa nga punët dhe projektet e rëndësishme të filluara gjatë vitit të kaluar kanë përfunduar dhe në rastet e tjera është shënuar përparim i dukshëm. Në këtë kontekst, vlen të përmendet veçanërisht përparimi i shënuar në zhvillimin legjislativ në fushën e konkurrencës, qoftë në ligjin e ri apo instrumentet dytësore ligjore, thellimi i bashkëpunimit me rregullatorë të sektorëve të ndryshëm, si dhe fuqizimin e kapaciteteve të AKK-së, që përfshinë trajnime të avancuara të zyrtarëve tanë nga ekspertë me përvojë të gjatë evropiane. Inspektorët Hetues të AKK-së kanë qenë gjatë tërë vitit duke monitoruar tregjet në Kosovë, ndërsa punët kanë vazhduar edhe në trajtimin e disa rasteve që tashmë janë hapur për hetim. Gjatë këtij viti, poashtu kemi filluar një riorganizim strukturor të institucionit bazuar në praktikat më të mira të vendeve të BE-së dhe rajonit. Një ristrukturim i AKK-së ka për qëllim që të shtojë efektshmërinë e punës, llogaridhënien si dhe transparencën e punës së Autoritetit.

Edhe gjatë këtij viti, ne kemi gëzuar mbështetjen e vazhdueshme që kemi pranuar nga Projekti i financuar nga Komisioni Evropian, "Mbështetja e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisioni e Ndhmës Shtetërore", përfitues kryesor i të cilit është AKK. Ky projekt ka ndihmuar institucionin tonë në të gjitha fushat e lartpërmendura dhe përkrahja e tij do të vazhdojë dhe gjatë vitit të ardhshëm. Për fat të keq, gjatë pjesës së dytë të këtij viti, Autoriteti Kosovar ka funksionuar pa organ vendimmarrës për shkak të përfundimit të mandatit të ish-kryetarit dhe katër anëtarëve të tjerë të Komisionit të AKK-së. Shpresojmë që ky organ të zgjidhet sa më parë në mënyrë që vitin 2022 të intensifikojmë edhe më shumë punët e nisura.

Sakip Imeri,
Drejtor i Përgjithshëm i
Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

DREJT NJË LEGJISLACIONI TË RI PRIMAR E SEKONДАР TË KONKURENCËS, NË PËRPUTHJE ME STANDARDET E BE-SË

Një nga angazhimet më të rëndësishme të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës gjatë vitit 2021 ka qenë hartimi i legjislacionit të ri primar dhe sekondar të konkurrencës. **Draftligji për Mbrojtjen e Konkurrencës është miratuar në parim nga deputetët e Kuvendit të Kosovës**, kurse aktualisht po trajtohet në komisionin përgjegjës të Kuvendit. Ky draft-ligji, i cili është hartuar edhe me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë të angazhuar nga Projekti i Komisionit Evropian, pritet që të jetë në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e Bashkimit Evropian për konkurrencën. Draftligji pritet do t'i garantojë AKK-së mandat më të gjerë dhe do të kontribuojë në përmirësimin e konkurrencës në vend. Fillimisht, Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës është miratuar më 2010 nga Kuvendi i Kosovës ndërsa në vitin 2014 ky ligj është plotësuar për t'i mundësuar më shumë fuqi AKK-së

Por, përveç ligjit primar, përparim i dukshëm është shënuar edhe në hartimin e instrumenteve dytësore legjislative. Në shtator, katër draft-udhëzues dhe ndryshime në tri instrumente të legjislacionit dytësor që ndërlidhen me draft ligjin e ri për Mbrojtjen e Konkurrencës janë prezantuar para drejtuesve të AKK nga ekspertët ndërkombëtarë të angazhuar nga Projekti i BE-së.

Draft-udhëzimet e prezantuara para AKK-së përfshijnë draft udhëzimin për përcaktimin e pozitës dominuese, draft udhëzimi mbi abuzimin me pozitë dominuese dhe draft udhëzimet mbi vlerësimin e efekteve të përqendrimeve horizontale dhe jo horizontale.

Në anën tjetër, amendamente specifike janë propozuar në këto instrumente të legjislacionit dytësor: Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2012 mbi format e paraqitjes së kërkesave dhe kritereve për përcaktimin e përqendrimit të ndërmarrjeve, në Rregulloren Nr. 04/2018 mbi Rregullat e procedurës së Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

Edhe **tetë instrumente dytësore ligjore të tjera** që lidhen me draft ligjin e ri do të prezantohen gjatë viti 2022.



NJË QASJE UNIFORME NDAJ POLITIKAVE TË KONKURENCËS NË SEKTORË TË RREGULLUAR

#avokim

Sigurimi e konkurrencës së ndershme lidhet drejtpërsëdrejti me efikasitetin e avokimit për politika të konkurrencës. Në fakt, avokimi i konkurrencës vlerësohet si shtyllë e dytë në të cilën mbështeten autoritetet e konkurrencës kur mbrojnë konkurrencën efektive, pasi në përgjithësi pranohet se **zbatimi dhe avokimi i konkurrencës janë komplementare në luftën kundër shkeljeve të konkurrencës**. Është veçanërisht e rëndësishme për autoritetet e reja të konkurrencës, siç është rasti me AKK-në, që t'i kushtohet rëndësi më e theksuar avokimit, në përpjekje për të siguruar një qasje uniforme të konkurrencës në sektorë të ndryshëm.

Në këtë kontekst, gjatë vitit 2021, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka qenë i angazhuar që të organizojë **ngjarje të ndryshme me rregullatorë të sektorëve të ndryshëm**, që përveç se janë shfrytëzuar për avokim, kanë pasur qëllim edhe të thelojnë bashkëpunimin mes autoriteteve. Këto ngjarje janë organizuar në bashkëpunim me Projektin e Komisionit Evropian, "Mbështetja e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës he Komisionin e Ndihmës Shtetërore", përfitues kryesor i të cilit është AKK

Trajnime dy-ditorë gjatë këtij viti janë zhvilluar me zyrtarët e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), zyrtarët e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).

Një fokus tjetër dhe **tejet i rëndësishëm ka qenë trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve** për t'i trajtuar rastet e konkurrencës. Në fund të muajit dhjetor, u organizua sesioni i parë në serinë e katër trajnimeve që do të organizohen për gjyqësorin dhe prokurorët në Kosovë, e në të cilat do të marrin pjesë edhe zyrtarët e AKK-së. Avokimi për Ligjin e Konkurrencës në sistemin e drejtësisë është i një rëndësie të veçantë sepse është thelbësore që të ketë gjyqtarë dhe prokurorë të mirëpërgatitur për trajtimin e rasteve të konkurrencës.



Publikime

Një nga aktivitetet e rëndësishme avokuese gjatë këtij viti ka qenë **edhe publikimi i 10 broshurave informuese**. Këto broshura, të cilat janë përmbledhur gjithashtu edhe në një libërth të veçantë, sqarojnë tema të ndryshme lidhur me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe politikat e konkurrencës në përgjithësi, siç janë “Rëndësia e konkurrencës për ekonominë e Kosovës”, “Marrëveshjet e ndaluara Anti-konkurrese”, “Procedurat e hetimit të shkeljeve të Konkurrencës”, “Pozitat Dominuese dhe Abuzimi me dominimin” e të tjera. Këto broshura janë të qasshme për publikun e gjerë përmes web faqes së AKK-së por edhe në formë të printuar.

Një publikim tjetër i rëndësishëm ka qenë **Fjalori Terminologjik i Konkurrencës**, i cili përveç shprehjeve të nxjerra nga instrumentet ligjore (legjislacion primar dhe sekondar) ose praktikat gjyqësore, përfshinë edhe shprehje që janë në përdorim të zakonshëm në lidhje me analizën ekonomike në rastet e rëndësishme të konkurrencës në Bashkimin Evropian dhe nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, të tilla si Rrjeti i Konkurrencës Ndërkombëtare, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), Shoqata e Kombeve të Azisë Juglindore (ASEAN) dhe Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD).

Ky fjalor mund t'u shërbejë palëve të ndryshme të interesit, siç janë vetë zyrtarëve të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, rregullatorëve sektorialë, komunitetit të biznesit, avokatëve e gjykatave.




Memorandume të Bashkëpunimit

Gjatë vitit 2021, AKK ka vënë bazën e mirë për bashkëpunim në të ardhmen me institucione të ndryshme. Një Memorandum Bashkëpunimi është nënshkruar me Administratën Tatimore të Kosovës si dhe me Kolegjin AAB dhe Kolegjin UBT, duke synuar që të avancohen njohuritë për politikat e konkurrencës edhe në fushën akademike në Kosovë.

Memorandumi i nënshkruar me ATK-në në muajin shkurt të këtij viti ndër tjerash, trajton edhe çështjen e inkasimit të detyrueshëm të sanksioneve administrative të shqiptuar nga AKK, bazuar në procedurat administrative të ATK-së. Më konkretisht, në ato raste kur ndërmarrja nuk e bën në afat të paraparë pagesën e masës së shqiptuar ndëshkuese, AKK e njofton ATK-në në zonën në të cilën banon respektivisht selinë e personit të dënuar, për të paguar shumën e masës ndëshkuese të shqiptuar, në mënyrë të detyrueshme sipas dispozitave për pagesën e tatimit.

Kurse memorandumet me kolegjet ka të bëjë me bashkëpunimin për zhvillimin e moduleve dhe programeve të ndryshme të studimit për fushën e konkurrencës, duke përfshirë që të ardhmen në kurrikulën e studimit një lëndë për fushën e politikave të konkurrencës si dhe palët gjithashtu janë dakorduar për organizimin e përbashkët të ngjarjeve akademike dhe profesionale si: simpoziume, seminare, konferenca, tryeza, shkolla verore, trajnime e të tjera. Gjithashtu, sipas këtij memorandumi, zyrtarët e AKK-së do të mund të mbajnë ligjërata me tema të veçanta që lidhen me konkurrencën para studentëve të Kolegji AAB si dhe u mundëson zyrtarëve të AKK-së që t'i botojnë punimet akademike në revistën shkencore THESIS në përputhje me standardet që i përcakton redaksia e revistës.



TRAJNIME TË AVANCUARA TË KONKURENCËS NGA EKSPERTË NDËRKOMBËTARË

Përveç pjesëmarrjes në trajnimet e përbashkëta sektoriale përgjatë tërë vitit, zyrtarët e Autoritetit kanë ndjekur trajnime të ndryshme, të cilat përgjithësisht kanë mbuluar tema që përbëjnë shtyllat kryesore të punës dhe mandatit të AKK-së, siç janë abuzimi me pozitën dominuese në treg, marrëveshjet e ndaluara/kartelet dhe përqendrimet. Këto trajnime janë organizuar nga Projekti "Mbështetja e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore", që ka angazhuar ekspertë me përvojë të gjatë në arenën ndërkombëtare.

Në kuadër të Programit të Trajnimeve të Projektit, vetëm në muajin shkurt janë organizuar katër sesione trajnimesh. Për shkak të kufizimeve të shkaktuara nga pandemia, këto trajnime janë zhvilluar përmes platformave online.

Kurse, gjatë muajve shtator dhe tetor, është mbajtur një seri prej tre modulesh të trajnimeve të avancuara. Në modulën e parë të trajnimeve, eksperti Dr. Pajtim Melani, ish-zyrtar i Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës, ka prezantuar lidhur me pozitën dominuese dhe keqpërdorimin e këtij statusi. Moduli i dytë lidhur me kontrollin e përqendrimeve është zhvilluar nga eksperti Dr. Paul Prisecaru, ndërsa moduli i fundit mbi marrëveshjet e ndaluara dhe kartelet është zhvilluar nga profesor Michael Saller, i cili aktualisht është ligjërues i Ligjit të Konkurrencës në Frankfurt të Gjermanisë.

Ekspertët që kanë mbajtur prezantimet kanë hartuar edhe udhëzues (manual) specifik, përkritazi me fushat që ata kanë prezantuar. Këta udhëzues do të jenë të dobishëm për zyrtarët e AKK-së gjatë trajtimit të rasteve në të ardhmen.

Një numër i konsiderueshëm i trajnimeve për stafin e AKK-së janë zhvilluar që nga viti 2019 kur ka filluar së zbatuari Projekti i Komisionit Evropian. Disa vizita studimore, që kanë qenë të planifikuara të zhvillohen në disa vende të Bashkimit Evropian gjatë këtij viti, janë shtyrë për vitin 2022.

Projekti pritet që gjatë muajit shkurt t'i ndajë certifikata të pjesëmarrjes zyrtarëve të AKK-së që kanë marrë pjesë në këto trajnime

AUTORITETI VAZHDON TË MONITOROJË ZHVILLIMET RRETH LIGJIT DHE POLITIKAVE TË KONKURENCËS NE BE

Në një vit kur Autoriteti ka punuar aktivisht për të avancuar harmonizimin e ligjit dhe politikës së konkurrencës së Kosovës me standardet e BE-së, Autoriteti gjithashtu vazhdoi të monitorojë zhvillimet në BE që lidhen pikërisht me ato standarde të BE-së. Disa nga zhvillimet më të rëndësishme në ligjin dhe politikën e konkurrencës të BE-së gjatë vitit 2021 janë përmbledhur këtu.

Disa nga vendimet më të rëndësishme të gjykatave evropiane në vitin 2021 në këtë fushë janë:

Rasti C-595/18 P - The Goldman Sachs Group v Komisioni Evropian, në të cilin Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka hedhur poshtë një apel të bankës investuese Goldman Sachs ndaj një gjobe të shqiptuar ndaj saj, e cila si kompani mëmë e një dege italiane u gjet se ka marrë pjesë në një kartel të kablove elektrike. Në këtë rast, gjykata zbatoi parimin e vendosur prej kohësh të rastit Akzo Nobel (2007) sipas të cilit, një kompani mëmë që ushtron “ndikim vendimtar” ndaj një filiali mund të mbahet përgjegjëse për shkeljen e ligjit të konkurrencës të atij filiali.

Rasti C-450/19 - Kilpailu- ja kuluttajavirasto në të cilin Gjykata e Drejtësisë e BE-së ua ka sqaruar gjykatave finlandeze se kohëzgjatja e një shkelje karteli në rastet e manipulimit të ofertave zgjatë deri në datën e nënshkrimit të kontratës në mes të kompanisë manipuluese dhe palës kontraktuese, bazuar në ofertën e paraqitur më herët, me kushtin që kontrata përcakton të gjitha aspektet përmbajtjesore të kontratës, përfshirë çmimin që do të paguhet; dhe

Rastet e bashkuara C-586/16, C-588/16 P, C-591/16 P, C-601/16 P, C-611/16 P, and C-614/16 P, Lundbeck dhe tjerët v. Komisioni Evropian, kur Gjykata e Drejtësisë e BE-së ka hedhur poshtë apelet e një kompanie farmaceutike daneze, Lundbeck, dhe e ka përkrahur vendimin e Komisionit Evropian në një rast të rëndësishëm lidhur me një skemë “paguaj për vonesën” lidhur me një ilaç anti-depresiv me një patentë të skaduar, që ka penguar konkurrentët e tjerë të prodhojnë një ilaç tjetër konkurrues. Gjykata ka konfirmuar se kjo ka qenë një shkelje serioze dhe e qëllimshme.

Rasti C-30/20: Volvo dhe të tjerët, në të cilin Gjykata Evropiane ka sqaruar juridiksionin e gjykatave për të vendosur për dëmshpërblimet në rastet e kartelit. Me pak fjalë, pas një karteli të provuar, një palë e dëmtuar mund të kërkojë kompensimin qoftë nga gjykatë në juridiksionin e së cilës është blerë malli i ndikuar

AUTORITETI VAZHDON TË MONITOROJË ZHVILLIMET RRETH LIGJIT DHE POLITIKAVE TË KONKURENCËS NE BE

nga karteli; ose në ato raste kur blerja ka ndodhur në disa vende, në juridiksionin e gjykatës ku është l vendosur ankuesi – si vendi kur ka ndodhur dëmi

Rasti C-882/19 Sumal në të cilin Gjykata Evropiane lëshuar një vendim për një gjykatë spanjolle lidhur me atë nëse një filiali të një anëtari të kartelit mund t'i kërkohet dëmshpërblim bazuar në Ligjin e BE-së. Në aktgjykimin, Gjykata ka thënë se “viktima e një shkeljeje të Ligjit evropian të konkurrencës të bërë nga një kompani mëmë, mund të kërkojë dëmshpërblim nga filiali i asaj kompanie për humbjet, nëse mund të provohet se të dy kompanitë kanë konstituar një njësi ekonomike në kohën e shkeljes”

Shkeljet në formë karteli

Autoriteti ndoqi gjithashtu nga afër vendimet kryesore të Komisionit Evropian në vitin 2021 në lidhje me shkeljet e kartelit dhe gjobat e vendosura ndaj Valve (video-lojëra), hekurudhave belge, gjermane dhe austriake (në lidhje me një kartel hekurudhor mallrash), Daimler, BMW dhe Volksëagen (për marrëveshje teknike), Banka e Amerikës, Merrill Lynch, Crédit Agricole dhe Credit Suisse dhe banka të tjera të mëdha (për tregti të fshehtë të obligacioneve) dhe karteli italian i perimeve të konservuara. Përveç kësaj, Autoriteti po ndjek një sërë hetimesh të reja të nisura nga Komisioni Evropian në vitin 2021 në tregje të tilla si shitja e ëmbëlsirave (rasti Mondelez), ilaçet e sklerozës së shumëfishtë (rasti TEVA) dhe abuzimi i supozuar i pozitës dominuese nga Apple Inc. në lidhje me transmetimin e muzikës dhe sektorët e energjisë elektrike të disa vendeve. Po monitorohen gjithashtu “bastisjet e agimit [apo, kontrole të paparalajmëruara” të nisura nga Komisioni në sektorët e mbrojtjes, të drurit dhe tekstilit.

Përqendrimet

Sa i përket përqendrimeve, Autoriteti vazhdimisht monitoron vendimet e Rregullatorit të BE-së, duke analizuar bazën e vendimeve në ato raste. Qindra vendime për përqendrimet janë marrë nga Komisioni Evropian gjatë vitit 2021 dhe janë aprovuar përëndime siç kanë qenë të njoftuar (duke mos gjetur ndonjë shqetësim për konkurrencën e drejtë). Disa të tjera kanë marrë aprovim të kushtëzuar dhe zotime për shitje nga firmat e përfshira, në mënyrë që të adresohen shqetësime specifike të konkurrencës për situata pas-përqendrimeve – për shembull, në rastin e blerjes së Refinitiv nga London Stock Exchange.


AUTORITETI VAZHDON TË MONITEROJË ZHVILLIMET RRETH LIGJIT DHE POLITIKAVE TË KONKURENCËS NE BE

Në fushën e kontrollimit të bashkimeve, në vitin 2021 kanë ndodhur disa raste të pazakonta, si për shembull:

- Vendimi i Komisionit Evropian për të gjobitur firmës Sigma-Aldrich me 7.5 milionë euro për dhënien e informacionit të pasaktë në sektorin e kemikateve në vitin 2015;
- I pari vendim i Komisionit Evropian për një masë të përkohshme për një dështim të supozuar për të pritur një kontroll të bashkimit, në rastin e propozimit të blerjes së Illumina nga klienti GRAIL (rast lidhur me teste që detektojnë kancerin), e në të cilin Komisioni më herët kishte shprehur shqetësimet serioze lidhur me konkurrencën sa i përket kësaj blerje.

Legjislacioni i ri i BE-së për konkurrencën

Legjislacioni i ri i konkurrencës në BE është poashtu i rëndësishëm për zotimet e Kosovës për të përafuar në plotni ligjin e vet me standardet e BE-së. Në vitin 2021, BE-ja ka vazhduar punën për të rishikuar Rregulloren e Bashkimeve, pastaj për të ndryshuar Udhëzuesin për përcaktimin e "tregjeve relevante" në rastet e konkurrencës dhe për të përditësuar rregulloren e rëndësishme për përjashtimet në bllok të marrëveshjeve horizontale dhe vertikale





AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENÇËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY



Funded by
the European Union



Ky buletin është përkrahur nga Projekti EU Support to the Kosovo Competition Authority and State Aid Commission. Përmbajtja e tij është përpiluar në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës, dhe është përgjegjësi e tyre dhe e B&S Europe dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.